

20101673577

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR ORGANIZIMIN DHE PUNEN
E ORGANEVE TË ADMINISTRATES SHTETERORE

Neni 1

Në Ligjin për organizimin dhe punen e organeve të administrates shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 58/2000, 44/2002 dhe 82/2008), në nenin 11 pika 13 ndryshohet si vijon:

"13. Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administrates;"

Neni 2

Në nenin 12 paragrafi (1) pas alineës 4 shtohet alineja e re 5, si vijon:

"- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Republikës së Maqedonisë,"

Neni 3

Në nenin 17 paragrafi (1) alineja 2 shlyhet.

Në alinën 12 fjalet: "dhe administrative" shlyhen.

Alineja 13 shlyhet.

Në paragrafin (2) alineja 1 shlyhet.

Neni 4

Në nenin 21 paragrafi (1) alineja 4 fjalet: "bagetisë dhe" shlyhen.

Në paragrafin (1) pas alineës 4 shtohet alineja e re 5, si vijon:

"-zbatimin e politikës në sferën e sigurisë së ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe shëndetësisë veterinarë,"

Në paragrafin (2) alineja 1 shlyhet.

Neni 5

Në nenin 22 paragrafi (1) alineja 6 fjalet: "produkteve ushqimore dhe" shlyhen.

Në paragrafin (2) alineja 2 shlyhet.

Neni 6

Neni 26-a ndryshohet si vijon:

"(1) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administrates i kryen punët që kanë të bëjnë me:

- zhvillimin dhe promovimin e shoqërisë informatike,
- krijimin dhe udhëheqjen e regjistrit të sistemeve informative dhe komunikuese dhe pajisjes informatike në kuader të organeve të administrates shtetërore,
- rrjetin e integruar informatik dhe komunikues, bazat e të dhënave, lidhjen e ndërsjelle dhe shkëmbimin e informatave, aspektet e sigurisë dhe zhvillimin e infrastrukurës së organeve shtetërore, personat juridikë dhe personat tjerë të cilët me ligj janë të ngarkuar që të kryejnë autorizime publike,
- ndjekjen e gjendjeve me teknologjitë informative dhe telekomunikuese dhe vendosjen e standardeve ndërkombëtare,
- telekomunikimet dhe infrastrukurën telekomunikuese;
- radiodifuzionin dhe infrastrukurën e radiodifuzionit,
- rregullimin ligjor të çështjeve lidhur me administratën,
- mbikeqytjen dhe sigurimin e zbatimit unik të rregullave që kanë të bëjnë me nepunesit shtetërore dhe publike,

- zhvillimin e politikës lidhur me të drejtat, detyrat, përgjegjësitë dhe vlerësimin e nepunësve shtetërorë dhe publikë,
 - klasifikimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, rrogave dhe kompensimeve të rrogave të nepunësve shtetërorë dhe publikë,
 - mbajtjen e Regjistrit të nepunësve shtetërorë dhe publikë,
 - përpilimin e dokumenteve strategjike për punë efikase dhe efektive, trajnimin dhe ngritjen profesionale të nepunësve shtetërorë dhe publikë, organizimin dhe realizimin e trajnimit,
 - zhvillimin dhe koordinimin e politikave lidhur me menaxhimin me resurse njerezore,
 - reformën në administratën publike,
 - realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështje në kompetencë të saj,
 - administratën shtetërore,
 - procedurën administrative,
 - mbikeqyrjen administrative dhe
 - kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj.
- (2) Në përberje të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës është:
- Inspektorati Shtetëror i Administratës."

Neni 7

Në nenin 27 paragrafi (1) alinete 5 dhe 6 shlyhen.

Neni 8

Pas nenit 33 shtohet neni i ri 33-a, si vijon:

"Neni 33-a

"(1) Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Republikës së Maqedonisë i kryen punët që kanë të bëjnë me sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshë; organizimin dhe përgjegjësinë në kryerjen e veprimtarisë veterinarë; realizimin, kontrollin, mbikeqyrjen dhe ndjekjen e aktiviteteve të veterinarisë në sferën e mbrojtjes shëndetësore të kafshëve; mbrojtjen dhe mireqenien e kafshëve lidhur me rritjen, ruajtjen, kujdesin dhe vendosjen e tyre, mbajtjen në ferma dhe shfrytëzimin, transportin, veprimin me kafshë për sigurimin e mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve; mbrojtjen dhe mireqenien e qenve dhe kafshëve kanakare, kafshëve në kopshtet zoologjike dhe kafshëve që shfrytëzohen për qellime eksperimentale dhe qellime tjera shkencore; nusproduktet me origjinë shtazore; identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve të fermave dhe kafshëve tjera; preparatet mjekësore veterinarë; kontrollin e kualitetit të ushqimit me përjashtim të prodhimit bujqësor primar dhe punë tjera me rëndësi të shëndetësisë veterinarë, sigurisë së ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

(2) Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Republikës së Maqedonisë e ka cilësinë e personit juridik."

Neni 9

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji:

- Ministria e Shoqërisë Informatike vazhdon të punojë si Ministri e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe
- Drejtoria e Veterinarisë dhe Drejtoria e Ushqimit vazhdojnë të punojnë si Agjenci e Ushqimit dhe Veterinarisë e Republikës së Maqedonisë.

Neni 10

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji të punësuarit në:

- Ministrinë e Shoqërisë Informatike vazhdojnë të punojnë në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës,

- Ministrine e Drejtesise që kryejne pune që kane të bejne me reformat në administraten publike dhe administraten shtetere, merren në Ministrine e Shoqerise Informatike dhe Administrates,

- Inspektoratin Shtetor Administrativ merren në Ministrine e Shoqerise Informatike dhe Administrates;

- Sekretariatit e Pergjithshem të Qeverise së Republikës së Maqedonise dhe Sekretariatit për Ceshnje Evropiane që kryejne pune që kane të bejne me reformen në administraten publike, merren në Ministrine e Shoqerise Informatike dhe Administrates dhe

- Drejtorine e Veterinarise dhe Drejtorine e Ushqimit, vazhdojne të punojne në Agjencine e Ushqimit dhe Veterinarise të Republikës së Maqedonise.

Pajisja, dokumentacioni dhe mjetet tjera të Ministrise së Shoqerise Informatike, mbeten në Ministrine e Shoqerise Informatike dhe Administrates.

Me ditën e fillimit të zbatimit të ketij ligji, pajisja, dokumentacioni dhe mjetet tjera nga:

- Drejtoria e Veterinarise dhe Drejtoria e Ushqimit, merren në Agjencine e Ushqimit dhe Veterinarise të Republikës së Maqedonise.

Neni 11

Të punesuarit në Ministrine e Transportit dhe Lidhjeve, të cilet i kryejne punet që kane të bejne me telekomunikimet, infrastrukturen telekomunikuese, radiodifuzionin dhe infrastrukturen radiodifuzive, si dhe pajisja, dokumentacioni dhe mjetet tjera, merren në Ministrine e Shoqerise Informatike dhe Administrates nga 1 janari 2012.

Neni 12

Dispozitat nga neni 6 i ketij ligji me të cilat ndryshohet neni 26-a lidhur me paragrafin (1) alinete 5 dhe 6, do të fillojne të zbatohen nga 1 janari 2012.

Dispozitat nga neni 7 i ketij ligji me të cilat në nenin 27 paragrafi (1) shlyhen alinete 5 dhe 6 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administrates shtetere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonise" numer 58/2000, 44/2002 dhe 82/2008), do të fillojne të zbatohen nga 1 janari 2012.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise", kurse do të filloje të zbatohet nga 1 janari 2011.